



Prishtinë, 24 dhjetor 2012
Kodi i ZRRE-së: V_489_2012

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 1.7 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L-185);
- Nenin 4, 5 dhe 13 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja; dhe
- Aplikacionin për Autorizim për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, në Lumin Lepenc, që përbëhet prej tri (3) njësive gjeneruese; HC III Kovaqicë me kapacitet prej 2*1500 kW, HC IV Kamenicë afër Kaçanikut me kapacitet prej 2*1750 kW dhe HC V Doganaj me kapacitet prej 2*1675 kW në total prej 9.85 MW, të gjitha në komunën Kaçanikut, të datës 07.06.2012 të ndërmarrjes “Matkos Group” sh.p.k., me adresë rruga “Nazim Gafurri” nr. 289, KK Prishtinë, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 24 dhjetor 2012 nxori këtë:

V E N D I M

Mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar

- I.** Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) konstaton se ndërmarrja “Matkos Group” sh.p.k., ka dëshmuar përshtatshmërinë për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga uji, në Lumin Lepenc, që përbëhet prej tri (3) njësive gjeneruese; HC III Kovaqicë me kapacitet prej 2*1500 kW, HC IV Kamenicë afër Kaçanikut me kapacitet prej 2*1750 kW dhe HC V Doganaj me kapacitet prej 2*1675 kW në total prej 9.85 MW, të gjitha në komunën Kaçanikut.
- II.** Aplikantit “Matkos Group” sh.p.k., mund t’i lëshohet **AUTORIZIMI** për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, pas përmbushjes së kërkesave që dalin nga Nenet 14 dhe 15 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit dhe kërkesave tjera të legjislacionit tjetër të aplikueshëm lidhur me ndërtimin e stabilimenteve të reja gjeneruese.
- III.** Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar nuk i jep të drejtë bartësit që të fillojë ndërtimin e stabilimenteve të reja gjeneruese para se t’i plotësojë të gjitha kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në pikën II. të këtij Vendimi.
- IV.** Vendimi mbi njoftimin për autorizimin preliminar i lëshohet ndërmarrjes “Matkos Group” sh.p.k. për dy (2) vite, dhe obligon aplikuesin që brenda kësaj periudhe të bëjë kërkesë me shkrim për lëshimin e Autorizimit për ndërtim të stabilimenteve të reja gjenerues nga uji.



Arsyetim

- ZRRE, me datë 07.06.2012 nga ndërmarrja “**Matkos Group**” sh.p.k., ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga uji, , në Lumin Lepenc, që përbëhet prej tri (3) njësive gjeneruese; HEC III Kovaqicë me kapacitet prej 2*1500 kW, HEC IV Kamenicë afër Kaçanikut me kapacitet prej 2*1750 kW dhe HEC V Doganaj me kapacitet prej 2*1675 kW në total prej 9.85 MW, të gjitha në komunën Kaçanikut.
 - ZRRE, pas vlerësimit të dëshmive të bashkangjitura aplikacionit dhe pranimi të dëshmive tjera plotësuese, të kërkuara nga ZRRE, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- V.** Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- VI.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar